



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 99 / Prot.

Tiranë, më 27/1 /2017

Lënda : Dhënie mendimi mbi përpunimin dhe transmetimin e të dhënave personale të klientëve të shoqërisë

Drejtuar: **Z. Avni PONARI**

Administrator i Përgjithshëm

Shoqëria e Sigurimeve SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a

Adresa: Bulevardi "Zogu i Parë", Qendra e Biznesit SIGAL, nr.1,

Tiranë

I nderuar Z. Ponari,

Referuar kërkesës tuaj, përcjellë me shkresën nr.53, datë 04.01.2017, nëpërmjet të cilës kërkohet një qëndrim zyrtar i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me transmetimin e mundshëm të të dhënave personale që përmbajnë kontratat e sigurimit të lëshuara nga shoqëria juaj në adresë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Zyra e Komisionerit ju përcjell vlerësimet e mëposhtme.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në kuadër të ushtrimit të aktivitetit mbikëqyrës mund të legjitimohet të aksesojë/përpunojë të dhënat personale të klientëve tuaj vetëm nëse plotësohet njëri nga kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 6 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Por në rastin konkret, pavarësisht faktit që baza ligjore e referuar nga AMF (Neni 131/4 i Ligjit nr.52, datë 04.01.2017 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe të risigurimit"), bërë me dije nga ana juaj, është e përgjithshme dhe në pamje të parë të krijon idenë e një aksesit të pakufizuar në informacion, kur bëhet fjalë për përpunim të të dhënave personale, analiza duhet të bëhet në raport me ligjin specifik. Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar, parashikon kufizimet që

referojnë në respektimin e parimeve të mbrojtjes së të dhënave (konkretisht parimi i mjaftueshmërisë).

Qëllimi i përpunimit të të dhënave nga ana e AMF-së, që është realizimi i mbikëqyrjes financiare, mund të arrihet nëpërmjet përpunimit të informacioneve të tilla si numri serial i policës, data, vlera dhe termat e policës. Në këtë kuadër aksesit/përpunimi i të dhënave personale të klientëve nga AMF, mund të konsiderohet në tejkalim të qëllimit dhe cënon parimin e mjaftueshmërisë së të dhënave (neni 5/c e ligjit).

Sigurisht që gjatë veprimtarisë mbikëqyrëse AMF mund të aksesojë dokumentacionin e kompanisë që përmban edhe të dhëna personale. Aksesit nuk është i pa kufizuar pasi lidhet me qëllimin e përpunimit. Kjo nënkupton që duhet të tregohet kujdes gjatë vlerësimit të kërkesave për akses në të dhëna personale në mënyrë që aksesit të ofrohet për aq sa e justifikojnë parashikimet ligjore dhe për një interes të ligjshëm.

Qëllimi i mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale të klientëve nga ana juaj është ofrimi i shërbimeve në fushën e sigurimit. Në këtë kuadër këto të dhëna nuk duhet të përpunohen për asnjë qëllim tjetër dhe aq më tepër të transmetohen në mënyrë periodike në adresë të të tretëve duke lënë hapësirë për krijim databazash të paligjshme dhe përpunim të paligjshëm të të dhënave në kuptim të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Një element shumë i rëndësishëm që duhet të merret parasysh kur përpunohen të dhëna personale është edhe siguria dhe konfidencialiteti. Zyra e Komisionerit vlerëson se transmetimi periodik i të dhënave personale (në format shkresor ose elektronik) ka impakt shumë të madh në sigurinë e të dhënave. Ky është një proces jo i lehtë kërkon një bazë të mirëfilltë ligjore dhe përcaktimin e detyrimeve konkrete midis palëve të përfshira (kontrolluesve), nëpërmjet marrjes së masave fizike, teknike dhe organizative dhe detyrimeve konkrete të palëve të përfshira

